

VENDIM
Nr.246, datë 27.2.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA GOSË TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gosë të qarkut të Tiranës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 3 (tre), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gosë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Komuna Gosë										
Nr. rend.	Nr.i pronës sipas VKM	Ekonomia/pyjore kullosore	Emri popullor i ngastrës	Nr. i ngastrës	Destinacioni	Sip. h	Funksioni i përdorimit të pronës	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	52	Malësia e Rrogozhinës	Kalush	70	Prodhues	18.25	Prodhues	MMPAU	DSHP Kavajë	Komunal
2	53	Malësia e Rrogozhinës	Ura e Copanit	71	Prodhues	11.5	Prodhues	MMPAU	DSHP Kavajë	Komunal
3	54	Kryevidh	Kurora e Vogël	46	Mbrojtës	14.25	Prodh. thupr	MMPAU	DSHP Kavajë	Komunal
		TOTALI				44.0				

Njësia e qeverisjes vendore Gosë		Lidhje 1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
52-54	Pyll	Pronësi